

VENDIM
Nr. 864, datë 10.12.2014

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE, NË EKONOMITË PYJORE “KRYEZI-BICAJ” DHE “MUNELLË”, QARKU SHKODËR, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA “BERALB” SHA, PËR AKTIVITET MINERAR DHE DEPOZITIM STERILESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 19.2 (nëntëmbëdhjetë pikë dy) ha, pjesë e ekonomive pyjore “Kryezi-Bicaj” dhe “Munellë”, qarku Shkodër, nga e cila 12.5 (dymbëdhjetë pikë pesë) ha do të përdoren nga shoqëria “Beralb” sh.a. për depozitimin e sterileve të dambës së fabrikës së pasurimit të bakrit, në Fushë-Arës dhe 6.7 (gjashtë pikë shtatë) ha për shfrytëzimin e shkëmbinjve efuzivë, në objektin “Munellë”, të hiqet nga Fondi Pyjor dhe Kullosor dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Sipërfaqja, sipas ngastrave pyjore dhe kullosorore jepet në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore, investimet e kryera në vite, në sipërfaqen, objekt i këtij vendimi, rrjeti rrugor, kanale vaditëse e ujësjellës, të paguhet nga shoqëria “Beralb” sh.a., në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Beralb” sh.a., brenda 3 (tre) viteve, duhet të pyllëzojë, me fondet e veta, 57.6 (pesëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) ha sipërfaqe me drurë pyjorë, në territorin administrativ ku ushtron aktivitetin, sipas përcaktimit në marrëveshjen e lidhur ndërmjet saj dhe Ministrisë së Mjedisit.

4. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrimin e Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe kullotave dhe në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

6. Shoqëria “Beralb” sh.a. pas përfundimit të punimeve të parashikuara, është e detyruar të realizojë rehabilitimin mjedisor të sipërfaqeve pyjore, sipas përcaktimeve në lejen mjedisore.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Beralb” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËNGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR
PËR AKTIVITETIN MINERAR TË SHOQËRISË “BERALB” SHA
QARKU SHKODËR

Lidhja 1

Nr.	Ekon.pyjore/kullosore	Ngastra	Sip.që hiqen (ha)
1	Kryezi-Bicaj	68/a	0.9
2	Kryezi-Bicaj	69/b	1.7
3	Kryezi-Bicaj	70/b	1.6
4	Kryezi-Bicaj	71/b	3.8
5	Kryezi-Bicaj	75/a	4.5
6	Munellë	27/c	0.2
7	Munellë	15/b	0.6
8	Munellë	17/b	0.5
9	Munellë	17/c	1
10	Munellë	19/c	0.4
11	Munellë	19/e	0.9
12	Munellë	23/a	0.3
13	Munellë	23/c	1.8
14	Munellë	23/d	0.4
15	Munellë	23/e	0.3
16	Munellë	24/c	0.3
GJITHSEJ			19.20